



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 91

Prishtinë: Dt. 17.7. 2024, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Blerta Deliu-Kodra dhe Time Kadrijaj.

Mungoi: Elmi Reçica.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi: Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt.4.7.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 08/L-295 për kriptu-asetet me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 4.7.2024

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 08/L-295 për kriptio-asetet me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, lidhur me kë të projektligj paraqiti opinionin ligjor dhe konstatoi se Projektligji Nr. 08/L-295 për kriptio-asetet, ka për qëllim rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me licencimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve që ushtrojnë veprimtari të ndërlidhur me emetimin, shpërndarjen, tregtimin dhe ruajtjen e kriptio-aseteve, kushtet e operimit dhe organizimit të operatorëve në fushën e emetimit, tregtimit dhe ruajtjes së kriptio-aseteve, kushtet dhe kriteret për transparencë gjatë emetimit dhe tregtimit të kriptio-aseteve në platforma tregtare, rregullat për mbrojtjen e konsumatorëve, lidhur me shërbimet e operatorëve për emetimin, tregtimin, shkëmbimin, ruajtjen dhe shërbimet e konsulencës, lidhur me kriptio-asetet, sanksionet në rastin e praktikave abuzive, si dhe çështje të tjera që lidhen me shërbimet në fushën e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë.

Ky projektligj përmban gjithsej 32 nene dhe 17 amendament nga Komisioni funksional dhe nuk është paraparë në PKIE-në 2024-2028.

Legjislacioni parësor i BE-së në fushën e veprimit të këtij projektligji nuk përmban rregulla specifike lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kriptio-asetet, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht është pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së, andaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Driton Hyseni, tha se disa deputetë të Kuvendit kemi bërë një nismë legjislative për hartimin e projektligjit për kriptio-asetet sepse e kemi parë të arsyeshme të ketë mundësi rregullimi i kësaj fushe, kemi ftuar ekspertë me renome, me qëllim që të kemi një ligj që trajton sferën e kriptio-aseteve. Jemi munduar t' i përfshijmë të gjitha direktivat e BE-së për të qenë ligji në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Përveç ligjit bazik, kemi parapa edhe akte tjera nënligjore që do t'i nxjerrin institucionet përkatëse, e sidomos Banka Qendrore, që do të merret me licencimin e operatorëve në trajtim të kriptioaseteve. Ky ligj do të plotëson nevojën për qytetarët tanë dhe ju ftoj që ta miratoni.

Kryetarja e hodhi ne votim projektligjin së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 08/L-295 për kript-asetet me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, përkatësisht është pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së, andaj rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Rrezarta Krasniqi
Kryetare e Komisionit